



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 309/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Koalicioni LDK-AKR, për shkak të vendosjes së posterave në afërsi të Qendrave të Votimit (QV) gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr 309/2017 e datës 12.06.2017 e parashtruar nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës, BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se në afërsi të qendrës së votimit 0402D në shkollën “Selami Hallaçi” në Gjilan në largësi prej 40-50 metrave ndodhej poster nga Koalicioni LDK-AKR. Parashtruesi i ankesës pretendon se kjo është në kundërshtim me nenin 36 pika a) të LZP.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar. Nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë Qendra e Votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr 309/2017 më datën 13.06.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*